




Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	19. 01. 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSACK	212/2021		113.



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.392/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.392/2020 të datës 04.12.2020 e parashtruar nga ankuesi _____ i cili përfaqësohet me autorizim nga Avokati Agron Kryeziu, me adresë rruga "William Walker", p.n. në Komunën e Malishevës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.392/2020 e datës 04.12.2020 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ në bazë të vendimit Nr.11/315 të datës 02.05.2017 është caktuar në pozitën "Ushtrues Detyre i Drejtorit në SHFMU _____ në Gurbardhë, në Komunën e Malishevës.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (tutje MASHT) dhe Kryetari i Komunës së Malishevës me datë 06.07.2018 arrijnë marrëveshje me Nr.3250, me të cilin ankuesin e transferojnë përhershëm nga pozita "U.D. Drejtor i SHFMU _____ në Gurbardhë" transferohet në sektorin e inspektimit të Arsimit në Gjakovë - Departamenti i Inspektimit të arsimit - MASHT në pozitën e punës "Inspektor i Arsimit".

Sipas ankuesit, ai nga data 07.07.2018 është paraqitur në vendin e punës, mirëpo deri në paraqitjen e ankesës ai nuk ka realizuar asnjëherë pagë dhe se ende nuk është futur në listën e pagave.


Ankuesi, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.12.2020 nëpërmes përfaqësuesit të tij Avokatit ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2949/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 08.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Më datë 21.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3236/2020 të datës 04.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për përfaqësimin e ankuesit i datës 23.10.2020; Marrëveshja nr.3250 e datës 06.07.2018; Akt emërimi i ankuesit i datës 09.07.2018; Kontrata e punës e ankuesit e datës 29.08.2017; Kërkesa për përgjigje e datës 08.12.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 21.12.2020; Vendimi për caktimin U.D. të Drejtorit në SHFMU¹ nr.11/315 i datës 02.05.2017; Emali zyrtar i datës 25.10.2018 nga - zv. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm MASHT z. Diploma e ankuesit, nr.379 e datës 20 nëntor 2015; Certifikata e datës 13.03.2012; Certifikata e datës 08.05.2020 për përfundimin e studimeve master në Kolegjin ISPE; Vendimi i datës 08.04.2019 me të cilin ankuesi caktohet mbështetës teknik për procesin e Vlerësimit të Përformancës së Mësimdhënësve; Marrëveshja për shërbime të veçanta e datës 08.04.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i MASHT dhe Kryetari i Komunës së Malishevës me datë 06.07.2018 arrijnë marrëveshje me Nr.3250, me të cilën ankuesin e transferojnë përhershëm nga pozita "U.D. Drejtor i SHFMU në Gurbardhë" transferohet në Sektorin e Inspektimit të Arsimit në Gjakovë - Departamenti i Inspektimit të arsimit - MASHT në pozitën e punës "Inspektor i Arsimit", rrjedhimisht nga kjo afati i ankimimit ankuesit ka filluar të rrjedh nga momenti që ai nuk ka realizuar të ardhura, respektivisht nga muaji Gusht 2018.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke llogaritur afatet si më lart, konstaton se ankuesi ankesën me numër protokollit 2949/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton se: **"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**, në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankueses është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.392/2020

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit z.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit në MASHT;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MASHT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

